

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja në sallën e gjyqit, Prokuroria mbyll hetimet dhe i komunikon akuzën Elvis Shkambit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/vrasja-e-gjyqtarit-astrit-kalaja-ne-sallen-e-gjyqit-p-rokuroria-mbyll-het-i588614
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:21:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8063071ea6a503cac5abb9a33a82fa38b0d3d7ffbd63c5e32a81bb0d655eb5f4
TEKSTI	3fbef5db63e2047a1a55861fff779c3b2db61d9b6b50b96c3004da55acc9f543
PAMJA	d98adcc882b7141cd92b3f92310a456dba088f483973edd1658df004891ec7e0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7feca4aaa2a94db99c06d81309de6668be7a6f6252dde75ab3895edaa46db4a0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f1d82a646bd703b2c3db300ad07fe31d63113d7410715c948367b3c04c7e5621
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7feca4aaa2a94db99c06d81309de6668be7a6f6252dde75ab3895edaa46db4a0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

ie [Skeme kontrabande ne Kapshtice dhe Kakavije, detyrime dhe penaltete nga kontrolli mbi 4 milion lekeGogu: Instituti per te miturit, gati deri ne mars 2027/Trump do te fundit](#)

Vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja në sallën e gjyqit, Prokuroria mbyll hetimet dhe i komunikon akuzën Elvis Shkambit



26 Shtator 2026, 21:45Kronika TEMA



Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të detyrës”, në kuadër të hetimeve për vrasjen e gjyqtarit të Apelit, Astrit Kalaja.

Gazetarja e Top Channel, Anila Hoxha, bën me dije se mbyllja e hetimeve për ngjarjen i është komunikuar sot Shkambit, i cili ndodhet në masën e sigurisë “arrest në burg”.

Ndërkohë, sipas të njëjtave burime, Gjon Shkambit, xhaxhait të Elvis Shkambit, akuza do t'i komunikohet ditën e hënë. Elvis Shkambi përballet gjithashtu me akuzën për “vrasje në rrethana cilësuese” të mbetur në tentativë, lidhur me plagosjen e dy personave, babë e bir, që ishin palë kundërshtarë në procesin gjyqësor.

Në fazat e mëparshme të procedimit, ndaj tij është hetuar edhe akuza për armëmbajtje pa leje. Sa i përket Gjon Shkambit, ai ka deklaruar se nuk kishte dijeni për planet e nipit të tij dhe se nuk ka pasur dijeni se Elvisi do të ndërmernte një veprim të tillë.

Ky qëndrim është bërë i ditur edhe më herët nga mbrojtja e tij, ndërsa Prokuroria ka ngritur dyshime për rolin e tij në ngjarje.

Çfarë ndodhi me gjyqtarin Astrit Kalaja?

Ngjarja e rëndë ndodhi më 6 tetor 2025, rreth orës 15:40, në ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë. Gjatë një seance gjyqësore, Elvis Shkambi qëlloi me armë zjarri drejt gjyqtarit Astrit Kalaja, si dhe drejt dy personave të tjerë, babë e bir, Ragip dhe Ervis Kurtaj, të cilët ishin palë në proces. Kalaja humbi jetën, ndërsa dy personat e tjerë mbetën të plagosur.

Sipas hetimeve të bëra publike nga Prokuroria, të shtënat ndodhën pasi gjyqtari Kalaja kishte lexuar vendimin në një çështje pronësie ku palë ishin familja Shkambi dhe familja Kurtaj. Prokuroria ka deklaruar gjithashtu se po hetonte rolin që mund të kishte pasur Gjon Shkambi në nxitjen e veprimeve ndaj palës kundërshtarë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gogu: Instituti për të miturit, gati deri në mars 2027](#)

20:10 Kronika

I dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit

19:20 Kronika

Transportonin emigrantë të paligjshëm, makinat përplasnin patrullën e policisë dhe largohen me shpejtësi

18:30 Kronika

Shpërthen në flakë autobusi në hyrje të tunelit të Elbasanit, bllokohet rruga

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.